



PASQYRA MAKROEKONOMIKE

Departamenti i Makroekonomisë përdorë të dhëna të publikuara nga institucionet relevante. Të gjitha burimet e të dhënave janë të paraqitura në fund të këtij publikimi.

Projeksionet Makroekonomike

Nr.06, Korrik – Shtator 2011

Bazuar në trendin e treguesve makroekonomik, gjatë vitit 2011 ekonomia e Kosovës pritet të shënoj një rritje vjetore të BPV-së prej 5.3%.

Konsumi i përgjithshëm, si kontribuuesi kryesor në rritje e BPV-së (4.7%), pritet të rritet me një normë prej 9.0%. Nga i cili, **konsumi privat** pritet të shënoj një rritje prej 8.6% si rezultat i rritjes së të ardhurave të disponueshme, ndërsa, **konsumi publik** pritet të rritet me një normë prej 11.1% krahasuar me vitin 2010.

Investimet e përgjithshme (me një kontribut në rritjen vjetore të BPV prej 0.6%) pritet të shënoj një rritje prej 7%, ku investimet **publike** pritet të rriten me 12.8% ndërsa ato **private** me 4.1%.

Për sa i përket **sektorit të jashtëm**, gjatë vitit 2011 pritet të shënohet një përqendrim në bilancin tregtar. Më saktësisht, **importet** e mallrave pritet të rriten me 13.2% ndërsa që **eksportet** e mallrave pritet të rriten me 10.5%.

Këto zhvillime pritet të ndikojnë në rritjen e **deficitit tregtar** në raport me BPV-në e vlerësuar, prej 40.8% në vitin 2010 në 41.8% në vitin 2011.


Gjatë vitit 2011, norma mesatare vjetore e rritjes së **Indeksit të Çmimeve të Konsumit (IÇK)** pritet të jetë rreth 7.4% nga 3.5% sa ishte në vitin 2010. Kjo si rezultat i madhësisë dhe strukturës ekonomike, lëvizjes së çmimeve në tregun ndërkombëtar dhe reflektimit të drejtpërdrejt në nivelin e çmimeve në Kosovë.

Sektori Real


Në mesatare, **Indeksi i Çmimit të Konsumatorit (IÇK)** për tremujorin e tretë të vitit 2011 shënoj 6.1%, përderisa mesatarja e IÇK-së deri në fund të muajit Shtator shënoj 8.5%.

Përgjatë periudhës raportuese, presionet inflacioniste në nivel global filluan të ngadalësohen. Pas një ngritjeje të theksuar të çmimeve në tremujorin e dytë të vitit 2011, **çmimet në tremujorin e tretë të vitit 2011 filluan të bien**.

Rritja vjetore e BPV -së , në përqindje (%)



Kontributi i komponentëve në rritjen e BPV-së, në përqindje (%)



Muaji Mars shënoj ngritjen më të theksuar të nivelit të përgjithshëm të çmimeve për vitin 2011, me inflacionin të regjistruar prej 10.8%, përderisa muaji **Shtator** shënoj rritjen më të ulët përgjatë këtij viti (**4.8%**).

Përgjatë tremujorit të tretë të vitit 2011, çmimet e **Bukës dhe Drithërave** shënuan një ngritje mesatare vjetore prej 22.5%, **Nafta dhe Benzina** shënuan një ngritje mesatare vjetore prej 13.5%. Përderisa rënie në çmime në muajin Shtator krahasuar me muajin paraprak, u vërejtën në produktet e **Pemëve (5.7%)** si dhe në **Bukë dhe Drithëra (1.3%)**.

Bazuar në të dhënat e ofruara, shihet se inflacioni shënoj ngritje të theksuar në pjesën e parë të vitit 2011 i udhëhequr kryesisht nga rritja e çmimit të bukës dhe e grurit (pjesërisht si rezultat i zjarrit në Rusi dhe fatkeqësitë tjera natyrore në shtetet e Detit të Zi siç janë Kazakistani dhe Ukraina). Po ashtu kontribut në rritjen e inflacionit ka pasur edhe ngritja e çmimeve të naftës, e ndikuar kryesisht nga zhvillimet në botën arabe.

Gjatë këtij tremujori u shënuan një rritje më e ngadalësuar e nivelit të çmimeve (edhe pse ende çmimet janë më të larta se sa gjatë periudhës së njëjtë të vitit të kaluar) dhe pritet se pjesa e mbetur e vitit të karakterizohet me stabilizim të çmimeve, kjo si rezultat i ngritjes së rezervave botërore të grurit dhe misrit, të mira të cilat patën ndikim të theksuar në rritjen e përgjithshme të çmimeve.

Sektori i Jashtëm

Eksportet dhe importet në tremujorin e tretë të vitit 2011 **performuan më mirë** në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Vlera totale e **eksporteve** në fund të muajit Shtator të vitit 2011 shënoj €241.6 milionë, vlerë kjo e cila përfaqëson një **ngritje vjetore prej 12.7%** krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Sikurse gjatë viteve paraprake, **metalet bazë** ishin produktet kryesore të **eksportuara**, duke arritur vlerën prej **€150 milionë** në fund të muajit Shtator të vitit 2011, pasuar nga produktet e mineraleve, ushqimore, plastika dhe druri, makineritë dhe pajisjet elektrike.

Për më shumë, partnerët kryesor tregtar mbetën të njëjtit sikurse në periudhat paraprake, ku vendet e BE-së mbesin destinacioni kryesor i produkteve nga Kosova.


Mallrat e importuara janë relativisht të diversifikuara dhe me pesha të balancuara në importin total, përderisa eksportet vazhdojnë edhe më tutje të jenë të koncentruara kryesisht tek **metalet bazë** të cilat në fund të periudhës raportuese **përbënin rreth 62% të eksportit total**.

Për sa u përket **importeve**, vlera nominale e tyre **arriti në €1,761 milionë** në fund të muajit Shtator të vitit 2011. Nëse krahasojmë tremujorin e tretë të vitit 2011 me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, vërejmë një ngritje **në importe prej 13.3%**.


Produktet minerale (kategori e cila përfshinë importin e naftës) është kategoria kryesore e importuar, pasuar nga Ushqimi i Përgatitur, Pijet dhe Duhani.

Në fund të muajit Shtator, **importet me origjinë nga vendet e BE-së** kanë shënuar vlerën prej **€657.1 milionë**, ndërsa importet me origjinë nga vendet e CEFTA-së shënuan vlerën prej €652.5 milionë.

Indeksi i Çmimit të Konsumatorit, IÇK (në %)



Importi, eksporti dhe bilanci tregtar, në miliona euro



Sektori Fiskal

Të Hyrat e Përgjithshme shënuan €933.1 milion, duke përafqësuar një rritje vjetore prej 4.0% me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Kjo shifër përfaqëson gjithashtu, realizim prej 74% ndaj të hyrave të planifikuara buxhetore

Të Hyrat nga Dogana shënuan një rritje vjetore prej 16.5% për të arritur në €590.9 milion në fund të muajit Shtator. Këto të hyra përbëjnë pjesën më të madhe të të hyrave totale (63%), pasuar nga të hyrat nga Tatimet Vendore (21%).

Të Hyrat nga Tatimet Vendore shënuan €193.4 milion, për të shënuar një rritje prej 22% në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Nga planifikimi i realizimit për fund vit (€261 milion), ATK deri në Shtator realizoj 68% të planit.

Në anën tjetër, shpenzimet totale Qeveritare në fund të muajit Shtator kapën vlerën prej €902.7 milionë, duke përfunduar tre mujorin e tretë me një bilanc pozitiv primar prej €30.4 milion.

Krahasuar tremujorin e tretë të vitit 2011 me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, shpenzimet e përgjithshme Qeveritare shënuan ngritje për 15%.

Kjo ngritje erdh si rezultat i rritjes së shpenzimeve kapitale prej 39%, në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, shpenzime këto kryesisht për financimin e ndërtimit të autostradës Merdare-Morine.

Gjithashtu, ngritje patën dhe shpenzimet rrjedhëse për rreth 11% si rezultat i rritjes së kategorisë për paga dhe mëditje pas ngritjes së pagave për kategori të caktuara të shërbyesve civil.

Sektori Financiar


Asetet totale të sektorit bankar në fund të muajit Shtator të vitit 2011 arritën në **€2.6 miliardë**, shifër e cila përfaqëson një ngritje për 15% në krahasim me periudhën e njëjtë të vitin 2010.

Totali i **depozitave** në sektorin bankar deri në fund të Shtatorit arriti vlerën në rreth **€2.1 miliardë** duke shënuar ngritje vjetore prej 18.1%. Nga këto 68% të depozitave përbëhet nga depozitat e ekonomive familjare ndërsa 21% nga korporatat jo-financiare.

Kreditë arritën vlerën prej **€1,6 miliardë** në fund të muajit Shtator 2011 duke shënuar një **ngritje vjetore** prej **16.8%**. Nga këto kredi rreth 66% ishin të drejtuara për korporatat jo financiare dhe pjesa e mbetur për ekonomitë familjare. Sektorët me pjesëmarrje më të madhe në kredi-marrje ishin sektori i shërbimeve, energjetikës, industrisë dhe ndërtimtarisë.

Norma mesatare e **interesit në kredi** shënoj **13.9%** gjatë muajit Shtator të vitit 2011, ndërsa norma e **interesit në depozita** shënoj **3.3%**.

Të hyrat buxhetore, në milion euro



Shpenzimet e përgjithshme buxhetore, në miliona euro




Tabela 1.

Agregatat kryesor ekonomik dhe fiskal

Përshkrimi	2011									Vjetore
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Jan- Shtator
	<i>(në miliona Euro, vetëm nëse tregohet ndryshe)</i>									
Sektori Real										
IÇK (në %)	7.4	9.5	10.8	10.6	10.4	9.2	8.3	5.3	4.8	8.5
Sektori i jashtëm										
Importi i Mallrave	132.7	148.9	190.5	195.8	207.9	217.5	222.1	229.3	215.6	1,760
Eksporti i Mallrave	22.9	25.7	26.4	29.0	29.3	30.8	29.4	23.8	24.3	242
Bilanci tregtar	-109.9	-123.2	-164.1	-166.8	-178.6	-186.7	-192.7	-205.5	-191.4	-1,519
Sektori Fiskal										
Të hyrat e përgjithshme	83.2	71.2	89.5	130.0	105.5	99.8	115.6	119.4	118.9	933.1
Të hyrat nga kufiri	44.3	48.7	56.0	59.7	70.4	73.0	75.3	85.6	78.0	590.9
Të hyrat vendore	32.4	13.7	13.2	31.8	14.9	15.6	28.8	23.1	20.0	193.4
Të hyrat jo tatimore	3.0	3.1	4.5	5.4	3.8	3.6	3.4	4.2	3.7	34.7
Te hyrat nga dividenta	-	-	5.0	30.0	10.0	-	-	-	15.0	60.0
Mbështetja buxhetore	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Shpenzimet e përgjithshme	36.4	89.5	49.3	133.8	91.2	127.9	120.0	182.6	71.9	902.7
Shpenzimet Rrjedhëse	14.6	76.4	33.3	88.1	37.1	77.7	68.7	107.9	43.1	546.9
Shpenzimet Kapitale	20.9	2.6	13.2	43.1	43.5	46.5	51.4	74.7	28.8	324.7
Sektori Financiar										
Depozitat	1,902	1,918	1,919	1,909	1,949	1,958	2,006	2,114	2,098	2,098
Kreditë	1,460	1,484	1,513	1,541	1,600	1,625	1,629	1,631	1,656	1,656
MHN te korporatave financiare			2,042			1,988			2,108	2,108

Burimi i të dhënave:Sektorit Real: Enti i Statistikave te Kosovës <http://www.ks-gov.net/esk/>Sektori Fiskal: Departamenti i Thesarit, MEF: <http://www.mef-rks.org/>Sektori Financiar dhe Sektori i Jashtëm: Banka Qendrore e Kosovës : <http://www.bqk-kos.org/>